

VENDIM
Nr. 175, datë 22.6.2026

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SHPK PËR MODIFIKIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 92 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.6.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1082/13 prot., datë 18.6.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 1’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, në zonën kadastrale nr. 3510, fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082 prot., datë 3.4.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikim, për ndryshim në aneksin A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 20 mw.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 110, datë 21.4.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 22.4.2026 dhe 23.4.2026. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat nr. 1082/4 prot., datë 24.4.2026 dhe nr. 1082/9 prot., datë 1.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim. Shoqëria ka kthyer përgjigje përkatësisht me shkresat nr. 1082/5 prot., datë 14.5.2026 dhe nr. 1082/10 prot., datë 8.6.2026.

- Për fillimin e kësaj procedure, ERE ka njoftuar dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 1082/3 prot., datë 24.4.2026. Nga ana e tyre nuk rezulton të ketë pasur ndonjë qëndrim në lidhje me këtë procedurë.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga palët e treta, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/7 prot., datë 20.5.2026, ka paraqitur objeksionet e tij z. A.Q., të cilat i janë vënë shoqërisë në dispozicion, nëpërmjet shkresës së ERE-s me nr. 1082/8 prot., datë 1.6.2026, duke i kërkuar sqarimet/argumentimet për çdo objeksion. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/12 prot., datë 11.6.2026, ka depozituar sqarimet/shpjegimet në lidhje me objeksionet e paraqitura.

- Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1082/11 prot., datë 10.6.2026, z. A.Q. ka depozituar objeksione/argumente shtesë në vijim të sa paraqitur më herët nga ana e tij.

Zgjatja e vendimarrjes

- Duke u mbështetur në përcaktimet e nenit 92, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim shqyrtimin e objeksioneve të ardhura dhe parashtrimet e depozituara nga shoqëria për këto objeksione, vlerësohet zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për modifikimin e licencës, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.5.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 mw, për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë z. A.Q. dhe shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti